



A.nr.386/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.386/2026 të datës 01.04.2026, të parashtruar nga ankuesja S.V të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Bajram Dili nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Sekretariatit i Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike, *“kërkesë nga marrëdhënia e punës”*, duke vepruar në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.08.2026, njëzëri, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.386/2026, e datës 01.04.2026, e parashtruar nga ankuesja S.V.

II. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të rishqyrtoj kërkesën e ankueses të datës 30.01.2026 dhe të nxjerrë akt administrativ në pajtim me dispozitat material dhe pikëpamjet juridike si në arsyetimin e vendimit.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja S.V (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja) më datë 01.04.2026, përmes përfaqësuesit të saj ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës të datës 02.03.2026 dhe vendimit për refuzimin e kërkesës së datës 10.02.2026, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të potë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të dispozitave të së drejtës materiale dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit të Ankesave, me datë 02.04.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa ky i fundit, me datë 14.04.2026, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me dokumentet e bashkangjitura të lëndës në çështjen përkatëse ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1613/2026 e datës 01.04.2026 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankueses; Autorizimin e datës 31.03.2026; Kërkesën për transferim e datës 30.01.202 nga ankuesja për Drejtorin e Përgjithshëm të SKPK-së; Emailin e datës 07.08.2025 nga ankuesja për Drejtorin e Përgjithshëm të SKPK-së; Emailin e datës 11.02.2026 nga F.I për ankuesen; Refuzimin e kërkesës për transferim datë 10.02.2026; Ankesën e datës 26.02.2026 nga ankuesja; Emailin e datës 02.03.2026 nga Burimet Njerëzore për ankuesen; Emailin e datës 13.02.2026 nga ankuesja për F.I; Emailin e datës 13.02.2026 nga F.I për ankuesen; Raportin mjekësor i datës 25.07.2025; ECG; Udhëzim për konsultim datës 20.05.2025; Raport nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (nuk shihet datë e protokoll); Udhëzim për konsultim datës 24.06.2025; Raport i vizitës specialistike lëshuar nga ASKLEPI MED; Raportin mjekësor i datës 11.07.2025; Raportin nga Klinika e Biokimisë mjekësore datës 24.06.2025; Fature 25-SHK01-014-16202; Raport mjekësor i datës 25.07.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.04.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 14.04.2026; Akt Emërimit e datës 01.08.2024.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, **sepse:**

I. Gjendja e çështjes

Nga administrimi i shkresat e lëndës rezulton se:

- Ankuesja sipas Akt emërimit me Nr.1973/2024, të datës 01.08.2024, është e punësuar në pozitën e punës “Zyrtare Ligjore”, në Zyrën për Mbështetje Juridike në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.
- Ankuesja fillimisht më datë 07.08.2025, përmes emailit i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, duke kërkuar transferimin në një ambient tjetër të punës që është i përshtatshëm për shkak të gjendje aktuale shëndetësore.
- Tutje më datë 30.01.2026, ankuesja i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me kërkesë për transferim në pozitë të njëjtë ose ekuivalente në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit apo Sekretariatit të Këshillit Prokurorial, me arsyetimin se kërkesa për transferim mbështetet në gjendje aktuale shëndetësore të vërtetuar sipas raporteve mjekësore.

- Udhëheqësi i Departamentit për Burime Njerëzore pranë Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 10.02.2026, ka njoftuar Administratoren e Prokurorisë Themelore në Prishtinë se kërkesa për transferimin e ankuses refuzohet me arsyetimin se një veprim i tillë është i panevojshme dhe mund të ndikojë në funksionimin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ndërsa, Administratorja e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, këtë email e ka përcjell tek ankuesit më datë 11.02.2026.

-Ankuesja më datë 26.02.2026, ka parashtruar ankesë ndaj këtij refuzimi tek Departamenti i Burimeve Njerëzore, ndërsa, ky i fundit përmes emailit të datës 02.03.2026, ka njoftuar ankuesen se si palë e pakënaqur ndaj refuzimit të transferimit mund të parashtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se refuzimi i transferimit nuk është mbështetur në gjendjen faktike sepse kërkesa e palës ka të bëjë ekskluzivisht me shëndetin e saj për shkak që vuan nga hipertensioni dhe kjo dëshmohet sipas raporteve mjekësor, e ambienti ku ushtron pozitën karakterizohet me ventilim të pamjaftueshëm dhe mungesë të ajrit të freskët. Kërkon që të aprovohet ankesa, të shfuqizohet njoftimi i datës 10.02.2026, të obligohet Sekretarit i Këshillit Prokurorial i Kosovës që të transferohet një ndonjëren nga pozitat në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit apo Sekretariatit në Këshillit Prokurorial, me të gjitha të drejtat dhe detyrat që burojnë nga marrëdhënia e punës.

III. Pretendimet e organit të punësimit përmes përgjigjes në ankesë

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes përgjigjes në ankesë të datës 14.04.2026, kundërshton pretendimet ankimore të ankuses duke theksuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara sepse pozita në të cilën ka kërkuar të transferohet ka koeficient të ndryshëm nga koeficienti që zyrtarja mban aktualisht me çka nënkupton se nuk kemi të bëjmë me pozita të barasvlershme. Në bazë të Rregullores Nr. 05/2026 për Klasifikimin e Vendeve të Punës, transferimi i nëpunësve mund të realizohet vetëm nëpërmjet pozitave që janë të së njëjtës kategori dhe me koeficient të njëjtë. Kërkojnë që ankesa të refuzohet dhe të mbetet në fuqi njoftimin i datës 02.03.2026.

IV. Vlerësimi i Kolegjit

Lidhur statusin e të punësuarve në administratën e Prokurorisë së Shtetit, Kolegji i Këshillit iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht:

-Nenit 1 [Qëllimi] ku përcaktohet se: *Ky ligj ka për qëllim rregullimin e marrëdhënies së punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës, përkatësisht përcaktimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë pranimin, klasifikimin e pozitave, ndryshimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, të drejtat dhe detyrimet në raport me marrëdhënien e punës, si dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës.*

-Nenit 5 [Kategoritë e zyrtares/it publik] ku përcaktohet se: 1. *Kategoritë e zyrtares/it publik janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artit dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit.*

-Nenit 6 [Nëpunësja/i civil me status të veçantë] paragrafi 4 ku përcaktohet se: 4. *Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë.*

Bazuar në kuadrin përkatës ligjor si më sipër, Kolegji thekson faktin se të punësuarit e administratës në Prokurorinë e Shtetit janë nëpunës civilë me status të veçantë, ashtu që marrëdhënia e punës së tyre rregullohet me akt të veçantë ligjor, rrjedhimisht, meqenëse Prokuroria e Shtetit ka rregulluar me akt të veçantë procedurën e vlerësimit të rezultate në punë të të punësuarve të administratës në këtë institucion, atëherë, trajtimi i çështjes në procedurë ankimore behët në pajtim me dispozitat e Rregullores Rregulloren Nr. 08/2024 për Transferimin dhe Avancimin e Nëpunësve Civil në Administratën e Sistemit Prokurorial, si akt nënligjor i aplikueshëm.

Rrjedhimisht, neni 4 paragrafi 1 i Rregullores Nr. 08/2024 për Transferimin dhe Avancimin e Nëpunësve Civil në Administratën e Sistemit Prokurorial, ka përcaktuar transferimin e përkohshme për interes të institucionit, për përmirësim të rezultateve në punë dhe për arsye të përkohshme shëndetësore, ndërsa, neni 7 i kësaj rregullore ka përcaktuar: “1. *Transferimi i përkohshëm për arsye shëndetësore bëhet me kërkesë të nëpunësit civil, pas vendimit të komisionit kompetent mjekësor.* 2. *Në vendimin e komisionit, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përcaktohet kohëzgjatja e nevojshme e transferimit të përkohshëm për arsye shëndetësore.* 3. *Pas pranimit të vendimit nga komisioni sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së nxjerr vendim për transferim*”, po ashtu edhe neni 10 i kësaj rregulloreje përcakton transferimin e përhershme ku thuhet: *Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i nëpunësi civil në një pozitë tjetër të shërbimit civil, në rast të: 1.1. paaftësisë shëndetësore për të kryer detyrat e pozitës së mëparshme... 2.Transferimi i përhershëm sipas nënparagrafeve 1.1. dhe 1.3. të paragrafit 1 të këtij neni bëhet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK dhe bëhet pas kërkesës së zyrtarit..*

Andaj, në kuptim të kuadrit ligjor si më sipër si dhe duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje referuar: LPPA), përkatësisht: nenit 10, paragrafi 2 ku përcaktohet se: 2. *Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative, nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, dhe si rrjedhojë*

Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore në raport me kërkesave të parashtruar nga ankuesja, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, duke qenë se dispozitat e Rregullores Nr. 08/2024 për Transferimin dhe Avancimin e Nëpunësve Civil në Administratën e Sistemit Prokurorial, kërkojnë që kërkesa të shqyrtohet me vendim nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, atëherë, ky i fundit është i obliguar që në raport me kërkesën e ankueses të datës 30.01.2026, të nxjerr akt administrativ duke vepruar në pajtim me dispozitat ligjore dhe rrjedhimisht transferimi i ankueses në një vend tjetër pune mund të konsiderohet i bazuar vetëm nën kushtin nëse kërkesa e ankueses mbështet me vendim nga organi kompetent mjekësor pranë Ministrisë së Punës i cili arsyeton transferimin e përkohshëm apo të përhershëm në varësi të gjendjes shëndetësore të ankueses.

Andaj, theksuar si me sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.386/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankueses Avokat Bajram Dili;
- Organit të punësimit: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.